

Njoftim për përqendrim me të cilin Shoqëria EVE GROUP SHPK Beograd, Republika e Serbisë do të fitojë kontroll të plotë mbi Shoqërinë tregtare OBLAK TEKNOLOGIJE SHPK Beograd–Zemun, Shoqërinë tregtare LIST COMPUTERS SHPK Beograd (Zemun), OBLAK DOCUMENT SOLUTIONS SHPK Beograd-Zemun, OBLAK KODER SHPK Beograd, CLOUDIS SHPK Beograd-Zemun, E CONSTRUCTIONS SHPK Beograd-Zemun, EVE LOGISTICS SHPK Beograd, EVE MONTENEGRO SHPK PODGORICA, Shoqërinë për tregti me shumicë të kompjuterëve, pajisjeve periferike kompjuterike dhe softuerëve IV DISTRIBUCIJA SHPKNJP Shkup

(lënda nr. 08-135 /2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 17.09.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim, me të cilin Shoqëria EVE GROUP SHPK Beograd, me seli në rr. Cara Dushana nr. 212, Zemun 11080 Beograd, R. e Serbisë, ka qëllim serioz të fitojë kontroll të plotë përmes blerjes së 100% të pronësisë mbi pjesët në shoqëritë e mëposhtme:

- **Shoqëria tregtare OBLAK TEKNOLOGIJE SHPK Beograd–Zemun**, me seli në rr. Cara Dushana nr. 212, Zemun, Beograd dhe me objekt veprimtarie prodhimin e kompjuterëve dhe pajisjeve periferike;
- **Shoqëria tregtare LIST COMPUTERS SHPK Beograd (Zemun)**, rr. Cara Dushana nr. 212, Zemun, Beograd dhe me objekt veprimtarie tregtinë me pakicë të kompjuterëve, njësive shtesë dhe softuerëve në dyqane të specializuara;
- **OBLAK DOCUMENT SOLUTIONS SHPK Beograd-Zemun**, rr. Cara Dushana nr. 212, Zemun, Beograd dhe me objekt veprimtarie veprimtaritë e bibliotekës dhe arkivit;
- **OBLAK KODER SHPK Beograd**, rr. Cara Dushana nr. 212, Zemun, Beograd dhe me objekt veprimtarie programimin kompjuterik;
- **CLOUDIS SHPK Beograd-Zemun**, rr. Cara Dushana nr. 212, Zemun, Beograd dhe me objekt veprimtarie programimin kompjuterik;
- **E CONSTRUCTIONS SHPK Beograd-Zemun**, rr. Cara Dushana nr. 212, Zemun, Beograd dhe me objekt veprimtarie ndërtimin e ndërtesave të banimit dhe jo banimit;
- **EVE LOGISTICS SHPK Beograd**, rr. Cara Dushana nr. 212, Zemun, Beograd dhe me objekt veprimtarie transportin rrugor të mallrave;
- **EVE MONTENEGRO SHPK PODGORICA**, rr. 8 Marsi nr. 55, Podgoricë dhe me objekt veprimtarie tregtinë me shumicë të kompjuterëve, pajisjeve kompjuterike dhe softuerëve;
- **Shoqëria për tregti me shumicë të kompjuterëve, pajisjeve periferike kompjuterike dhe softuerëve IV DISTRIBUCIJA SHPKNJP Shkup**, rr. 9 Maji nr. 5, Qendër dhe me objekt veprimtarie tregtinë me shumicë të pajisjeve informatike dhe të komunikimit.

Shoqëria EVE GROUP SHPK Beograd ka si objekt veprimtarie veprimtarinë e një kompanie holding.

Pjesëmarrësit në përqendrim si treg relevant për vlerësimin e përqendrimit të propozuar marrin: distribuimin, integrimin e sistemeve, shitjen me pakicë, transportin dhe logjistikën e pajisjeve IT dhe elektronikës së konsumit, veprimtaritë e ndërtimit të ndërtesave të banimit dhe jo banimit, si dhe aktivitetet e bibliotekës dhe arkivit.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni u bën thirrje palëve të treta të interesuara të dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre për këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr. 54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe ato duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

17.09.2025

Shkup